



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 919, datë 03. 08. 2009

per
komentet per projektdokumentin "Politikat per Komunikimet Elektronike ne
Republikën e Shqipërisë"

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|--------|---------|
| 1. Z. Ilir | Shehu | Kryetar |
| 2. Z. Afrim | Tonuzi | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira | Kasaj | Anëtar |
| 4. Z. Ilir | Zela | Anëtar |
| 5. Z. Jetmir | Karini | Anëtar |

në mbledhjen e datës 03. 08. 2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme të AKEP, shqyrtoi shkresën nr.3137 prot., date 31.07.2009, te Drejtorisë së Rregullimit Teknik dhe diskutoi mbi dokumentin e publikuar për konsultim publik nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit "Politikat për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë".

BAZA LIGJORE:

1. Neni 114 dhe 115, i ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë" (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 16 e nenit 21 "Rregullores së Brendshme të AKEP (ish ERT)" (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (VKD) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
3. Pika A.10 dhe D.1 të VKD nr. 917, date 23.07.2009 "Për planin e detajuar të veprimit të AKEP për vitin 2009".

Nga diskutimi:

V Ë R E H E T se :

Ne lidhje me procesin e konsultimit mbi dokumentin e “Politikave per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) e mbeshtet dokumentin e publikuar te politikave dhe beson se ai do te sherbeje si nje baze e sigurt per zhvillimin e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi si pjese e tregjeve me te zgjeruar European dhe boterore.

AKEP, duke pare rendesine e implementimit te dy aspekteve themelore te ketij dokumenti qe jane sherbimi universal dhe e drejta e perdorimit te prones publike dhe private, perqendroi komentet ne Kapitullin 8 dhe 10 te ketij dokumenti.

ATEHERE:

Për sa më sipër, me bindjen se miratimi i ketij dokumenti do t'i sherbeje krijimit te nje klime sa me te favorshme per investoret, zhvillimit dhe rritjes se konkuresces ne tregun e telekomunikacioneve, Keshilli Drejtues

V E N D O S I :

1. Miratimin e komenteve mbi projektdokumentin “Politikat per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise” sipas Lidhjes 1 bashkengjitur.
2. Dergimin e komenteve ne Ministrine e Puneve Publike Transportit dhe Telekomunikacionit brenda dates 03.08.2009.

Ky vendim hyn në fuqi në fuqi menjehere.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES
Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. Afrim TONUZI
2. Edlira KASAJ
3. Ilir ZELA
4. Jetmir KARINI

Lidhja 1

Komente mbi projektdokumentin “Politikat per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqiperise”

Ne lidhje me procesin e konsultimit mbi dokumentin e “Politikave per Komunikimet Elektronike ne Republikën e Shqiperise”, Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) e mbeshitet dokumentin e publikuar te politikave dhe beson se ai do te sherbeje si nje baze e sigurt per zhvillimin e tregut te komunikimeve elektronike ne Shqiperi si pjese e tregjeve me te zgjeruar European dhe boterore.

Komentet e AKEP konsistojne ne dy aspekte te politikës si me poshte vijojne:

Ne lidhje me Kapitullin 8: Sherbimi Universal dhe te drejtat e perdoruesve

AKEP e gjen me vend pyetjen ne fund te Kapitullit 8 (e perseritur me poshte):

A pajtoheni që Shqipëria duhet të forcojë të drejtat e përdoruesve?

Pergjegjesite e AKEP ne lidhje me sherbimin universal jane te percaktuara ne ligj. Ne thelb, kemi te bejme me sherbime te konsideruara te nevojshme per shoqerine, por te cilat, tregu i lire nuk mund t’i siguroje ne menyre spontane. Ligji vendos nje mekanizem nepermjet te cilit nje ose me shume operatore mund te kompensohen ne menyre te pershtateshme per sigurimin e sherbimeve te tilla. Ne ligj ekzistojne kufizime te sakta se si do te financohet dhe perdoret cdo kompensim per sigurimin e sherbimit universal.

AKEP mendon qe disa elemente te sherbimit universal (si disponueshmeria e informacionit ne numeratorin telefonik), nuk do te jene problematike dhe zbatimi i tyre do te jete, ne nje mase te gjere, ceshtje negociatash dhe rregullimesh praktike. Aspekti i panjohur, dhe qe nuk njihet deri me tani, ka te beje me menyren e arrijtes se nje akses universal gjithnje e me te madh ne sherbimet baze ne familje, per te gjithë territorin e vendit. Ky element qartesisht ka, ne menyre potenciale, implikime te kostove te medha te cilat e bejne ate kryesisht nje problem ekonomik. Per me teper, rritja e madhe e komunikimeve te telefonise se levizeshme ne keto vitet e fundit, ka ndryshuar pergjithmone supozimin qe ve perfund te gjithë masat e politikës se meparshme mbi sherbimin universal te cilat synonin ne menyre eskluzive ne zgjerimin e nivelit te rrjetit fikse.

Ne shpresojme, se gjate viteve 2009 dhe 2010 (kur rregullat e BE ne lidhje me sherbimin universal ka te ngjare te ndryshojne), te krijojme dhe zbatojme nje rregjim qe t’i pergjigjet realitetit ne Shqiperi dhe i cili mund te paqesohet me ligjet e BE (acquis) me qellim permiresimin e aksesit ne sherbimet baze per qytetaret.

AKEP do te mbetet i hapur per menyra me radikale per kete ceshtje. Ne lidhje me kompensimin per akses, prirja e pergjithshme ne vendet e EU eshte qe, gjithnje e me shume, tregu vet mund te mbeshitet ne kenaqjen e nevojave per sherbimet. Tashme, detyrimi per disponueshmerine e sherbimeve baze, ne zona te medha, eshte mundesuar me kosto me te lira nga rrjetet e levizeshme se sa nga rrjetet fikse. Pesha kryesore (jo per t’ju referuar rrezikut te shoqeruar te gjobave) e detyrimit te sherbimit universal ne Shqiperi, mund te funksionojë si nje faktor serioz friksues per cdonjerin operator qe kerkon kete status. AKEP do t’i nevojitet te marre ne konsiderate nese, ne rrethanat e tanishme, vendosja e nje detyrimi ka mundesi te pershpejtoje rritjen e penetrimit apo ta frenojë ate.

Ne lidhje me Kapitullin 10: E drejta e perdorimit te prones publike dhe private.

AKEP e gjen me vend pyetjen ne fund te Kapitullit 10 (e perseritur me poshte):

“A është i drejtë theksi i vënë mbi nevojën për të siguruar që të drejtat e pronës publike dhe private të mos shfaqin pengesa në këtë sektor (kapitulli 10)?”

AKEP mendon se theksi i vene per keto çeshtje eshte i drejte. AKEP eshte i te njejtit qendrim me Ministrine per te filluar sa me pare studimin, ne konsultim me AKEP, institucionet e tjera dhe grupet e interesit, per faktoret perkates qe pengojne investimet ne sektor, apo shkaktrojne drejtim jo-eficient te tyre, dhe per te implementuar masa per te permiresuar situaten, sic theksohet ne dokument dhe perseritet ketu me poshte:

Ne fasilitetet shoqeruese;

“Qeveria e konsideron se është e detyruar të bëjë çfarëdo ndryshimesh qe të jenë te nevojshme në ligje dhe rregullore të cilat qeverisin përdorimin e pronës publike dhe private për të siguruar që pengesat për zhvillimin e tregut janë zvogëluar.

Shumë raste kur është hasur në vështirësi ka mundësi të përfshijnë tubacionet nëntokësore të cilat zakonisht janë në pronësi të shtetit ose bashkisë”

Ne fasilitetet e tjera ne territore publike;

“Qeveria dëshiron të përmirësojë praktikën dhe rregullat mbi përdorimin e territoreve publike dhe ndërtesave për qëllime të komunikimeve elektronike në mënyrë që përfitimet të mund të ndjehen, të jenë më të shpejta dhe më të sigurta.”

“Qeveria prandaj propozon të bëjë një studim të situatës në këshillim me AKEP-in, industrinë, ministrinë përkatëse, autoritetet vendore dhe palë të tjera të interesuara private ose publike për të vendosur masat e nevojshme për përmirësimin e situatës.”

Aksesi ne pronen private;

“Qeveria dëshiron të sigurojë se të drejtat e pronës private nuk përdoren në mënyrë të tillë që të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tregut të shërbimeve të komunikimit elektronik.”

“Qeveria prandaj propozon të bëjë një studim të situatës në këshillim me AKEP-in, industrinë, ministrinë përkatëse, autoritetet vendore dhe palë të tjera të interesuara private ose publike për të vendosur çfarë masa mund të jenë të nevojshme për të rregulluar situatën.”

AKEP, me bindjen se miratimi i ketij dokumenti do t'i sherbeje krijimit te nje klime sa me te favorshme per investitoret, zhvillimit dhe rritjes se konkurrences ne tregun e telekomunikacioneve, mendon se komentet e dhena do ti sherbejne realizimit te nje dokumenti sa me cilesor qe t'i pergjigjet me se miri kerkesave ne rritje te ketij sektori.